



Fehmi AGANI

Përkundër përshtypjeve të shumta e të shpeshta se në Kosovë dhe për Kosovën nuk po ndodh asgjë e re, përshtypje kjo që forcohet nga bllokada e marrëdhënieve dhe të institucioneve shqiptare në Kosovë, të cilën Serbia po përpiqet ta mbajë të fortë e të plotë nga frika se mos, me dobësimin e saj, fillon shembja e sistemit të saj të shtypjes si dhe nga nevoja dhe dëshira normale që kemi që problemi i Kosovës të fillojë të zgjidhet, zhvillime të ndryshme të kohëve të fundit sikur paralajmërojnë fillimin e një faze të re të rëndësishme të rrjedhave rreth Kosovës.

Mund të përmenden nga këto rrjedha apo zhvillime vizita e kryetarit Rugova në Uashington dhe kjo e këtyre ditëve në Gjermani, biseda e disa nga përfaqësuesit e jetës politike shqiptare me z. Gelbart në Beograd dhe vizita e drejtorit politik në Ministrinë e jashtme gjermane në Prishtinë, si dhe në Tiranë e Shkup. Këtyre mund t'iu shtoj

jmë disa rrjedha politike në vetë Kosovën, si është fillimi i vitit shkollor dhe zhvillimet rreth tij, disa procese në marrëdhëniet ndërshtetërore që, sado të duken të parëndësishme në vetë vete, mund të rezultojnë me ndryshime të rëndësishme në skenën tonë politike.

Vështirë është ende të karakterizohen dhe vlerësohen në mënyrë pak a shumë të plotë vizitat dhe bisedat e përmendura, të nxirren përfundime përkatëse për to. S'ka dyshim se dr. Rugova u prit jashtëzakonisht mirë në Uashington, u shpreh qartë përkrahja amerikane për çështjen e Kosovës dhe zgjidhjen e saj, u ripërsëritën kushtëzimet që i bëhen Beogradit dhe lidhur me Kosovën. Por, u shënuan qartë edhe suazat brenda të cilave shtrihet përkrahja, limitet e kësaj përkrahje. Kjo, sigurisht do të përsëritet në Gjermani dhe përbënte gjithashtu karakteristikën apo përmbajtjen kryesore të bisedave me Gelbardin dhe Ishingerin. Këtë e shpreh edhe biseda e këtij të fundit në Dojçe Vele.

Limitet e përkrahjes së lëvizjes politike shqiptare jo që nuk janë

të lehta, por janë shumë atë rënda: Nuk përkrahet pavarësia e Kosovës dhe as ndryshimi i kufijve të Jugosllavisë, të këtij shteti ende, pa legjitimitet të qartë ndërkombëtar, zgjidhja për Kosovën kërkohet në formë të një autonomie, përmbajtja e së cilës duhet të përcaktohet me bisedime, pa përcaktime të qartë të raportit me Serbinë.

MUNDËSITË E SITUATËS SË RE

Por, të mos nxitojmë të nxjerrim vetëm përfundime negative, ta shohim gjendjen më të rëndë se është. Qëndrimet e përmendura të faktorëve ndërkombëtar nuk janë gjë e re, ato janë thënë shumë herë, thuajse vazhdimisht. E re është domosdoja e ballafaqimit të drejtpërdrejtë, e ndeshjes së paevitueshme me këto qëndrime. Por, domethënia e tyre e vërtetë mund të shihet, por të vështrohet situata në të cilën sillet Serbia. Iniciativa e sotme amerikano-gjermane apo amerikan-evropiane e fillon procesin e zgjidhjes për Kosovën dhe vetë fillimi i këtij procesi është goditje e rëndë për preten-

dimet dhe iluzionet serbo-hegemoniste për Kosovën. Definitivisht shembet iluzioni për Kosovën si pjesë e Serbisë dhe çështje e brendshme e saj. Autonomia që përmendet, e marrë në kuptimin evropian ose ndërkombëtar të sotëm, si autonomi e gjerë, me mundësi të jetë jashtë Serbisë dhe të ketë edhe trajtën e njësisë federale, të republikës, e then monopolin dhe sundimin serb mbi Kosovën dhe mund të krijojë një situatë të re, kur edhe në Serbi do të shihej në një mënyrë tjetër edhe Kosova, e edhe mundësia e pavarësisë së saj. Që të mos duken këto konkluzat tepër të guximshme, që don të thotë të pabazë, mjafton të shikohet pozita kualitativisht e ndryshme e shqiptarëve dhe e Serbëve në Kosovë. Me rreth 90 për qind të popullsisë së Kosovës, shqiptarët normalisht e kanë përcaktuar perspektivën dhe fatin historik të saj. Ata janë të interesuar të thehet sundimi, monopoli, bllokadat dhe shtrëngesat pushtuese. Serbia, përkundrazi, vetëm me forcë e dhunë, me ripushtime permanente mund ta ketë Kosovën. Bllokada e sotme i për-

DOMOS- DOSHMEËRIA E ARRITJES SË KONSENSUSIT SUBSTANCIAL NDËRSHTETËRORE